



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500577/11

Tiranë ___/___/2015

Lënda: Rekomandohet "*Fillimi i hetimit në ngarkim të shtetasit Keldi Keli etj, me detyrë inspektor pranë I.K.M.T Tiranë, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal*".

Drejtuar : Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Z.Arens ÇELA

L U S H N J E

Për dijeni: Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

T I R A N Ë

Të nderuar Zotërinj!

Më datën 15.04.2015, disa subjekte biznesi, banorë të Grabianit e Çermës në rrethin e Lushnjes kanë njoftuar Zyrën e Avokatit të Popullit duke ngritur shqetësimin se punonjësit e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, vijonin kryerjen e veprimeve për prishjen e objekteve të ndodhura në segmentin rrugor Rrogozhinë-Lushnje, në kushtet e cënimit të së drejtës së pronësisë e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

Në këto rethana është ndërmarrë kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, i cili është realizuar me shkuarjen në vënd të Ndhmës Komisionerëve të Avokatit të Popullit dhe kryerjen e veprimeve si, marrjen e shpjegimeve të personave të dëmtuar nga prishjet e ndërtesave, administrimin e akteve të ndryshme shkresore apo foto të disa objekteve para, ose pas prishjes së tyre.

Rrethanat e ngjarjes

Ngjarja lidhet me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.229 datë 11.03.2015, *“Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtvëshme që preken nga realizimi i projektit për rehabilitimin dhe gjelbërimin e zonave pranë rrethrotullimeve dhe kryqëzimeve në segmentin rrugor Rrogozhinë - Fier.”* Sipas pikës 2 të VKM-së, shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili ka dhe detyrimin e bërjes së shlyerjes së pronarëve pas çeljes së fondit, të përcaktuar në pikën 4 të tij. Në këto rrethana Autoriteti Rrugor Shqiptar me shkresën nr.2772, datë 11.03.2015, i është drejtuar me kërkesë për mbështetje IKMT-së.

Shqetësimi i qytetarëve ka konsistuar në aksionin e gjërë të marrë nga IKMT në të gjithë segmentin rrugor Rrogozhinë-Fier, për prishjen e objekteve të ndërtuara prej vitesh, për të cilat ishin pajisur me dokumente të rregullta pronësie, të ndërtuara me lejë ose që kanë qënë në proces legalizimi, në faza të ndryshme të zhvillimit të tij.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se nga IKMT-ja nuk janë respektuar procedurat ligjore për njoftimin dhe vendimmarrjen kundrejt subjekteve që iu nënshtruan prishjes së objekteve. Kështu:

Shtetasi Kujtim Kaja nga Grabiani i Lushnjës, prej vitit 2007, me dokumente të rregullta pronësie dhe lejë ndërtimi në sipërfaqen e truallit prej 630 m² kishte ndërtuar një objekt dy kate, pikë karburanti servis dhe zyra, ndërsa në katin e tretë banonte me pjestarët e tjerë të familjes së tij. Objekti është prishur më datë 16.04.2015.

Shtetasi Rustem Kokja banues në Çermë, kishte ndërtuar me dokumente të rregullta pronësie e lejë ndërtimi një objekt 2 kate, biznes, restorant ku punonte me pjestarët e familjes dhe të afërm të tij, objekti është prishur më datë 12.04.2015.

Shtetasi Avni Lila banues në Dushkë, ndërtuar objektin dy kate magazinë ekspozitë, me dokumente të rregullta pronësie dhe lejë ndërtimi prej vitit 2005, prishur objekti në datën 15.04.2015.

Shtetasi Nazmi Muça banues në Çermë, ndërtuar objektin katër kate, karabina, me dokumente të rregullta pronësie dhe me lejë ndërtimi prej vitit 2006, prishur më datë 11.04.2015.

Shtetasi Neim Lila nga Dushku, ndërtuar me dokumente të rregullta pronësie dhe me lejë qysh në vitin 2006, objektin me dy kate me sipërfaqe 406 m² me destinacion magazinë ekspozitë, prishur më datë 15.04.2015.

Në të njëjtat kushte paraqiten edhe shtetasit, Hasan Kokja, Shkëlqim Kokja, Sali Xhepa, Haki Xhepa, Kujtim Sako, Rrahman Balliu, Llazar Angjeli, Bashkëpronarët Xhepexhiu e Xhaja, sipas listës bashkëlidhur në VKM nr.229, datë 11.03.2015.

Veç sa sipër janë marrë shpjegime dhe disa shtetasve banues në Çermë, objektet apo ndërtesat e të cilëve nuk kanë qënë me lejë ndërtimi, por kanë qënë në proces legalizimi. I tillë është rasti i shtetasit Vath Kokja të cilit më datën 31.10.2014, nga ana e IKMT-së i është shëmbur shtëpia e banimit dhe një lokal njëkatësh me sipërfaqe 40 m²; shtetasit Luftim Dervishi po nga Çërma ndërtuar pa lejë në vitin 2008, një magazinë material ndërtimi në një sipërfaqe të përgjithshme 600 m², dhe brënda saj dy dhomë banimi për pjestarët e familjes; shtetasit Bujar Kokja ndërtuar pa lejë dy objekte nga dy kate, njëra nga të cilat ishte biznes dhe tjetra shtëpi banimi, të cilat ishin në proces legalizimi, prishur nga IKMT më datë 20.04.2015.

Më datën 22.04.2015, me shkresën nr.2375/1 nga IKMT-ja është kthyer përgjigje shkresës së Institucionit të Avokatit të Popullit nr.K3/R8-2 të datës 17.04.2015, duke sqaruar ndërmjet të tjerave se: *“IKMT është vetëm organ zbatues që veprimet e veta i kryen vetëm në përfundim të miratimit të procedurave përkatëse për prishjen e objekteve në kuadër të lirit të sheshit të ndërtimit, sipas projektit të zbatimit...”*

Konstatime dhe përfundime

Qysh në fillim shprehim mendimin konsequent të Institucionit të Avokatit të Popullit se jemi për zbatimin rigoroz të çdo akti ligjor të nxjerrë nga Këshilli i Ministrave, siç është dhe rasti konkret për shpronësime në interes publik duke respektuar parimin e sigurisë publike. Jemi të ndërgjegjshëm dhe për faktin se interesi publik duhet të prevalojë mbi të drejtën e pronës së shtetasve.

Si një institucion i pavarur në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore kemi misionin për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e administratës publike.

Kjo për faktin se në të gjitha rastet e hetuara për prishjen e objekteve nga Inspektorët e IKMT-së, qytetarët kanë patur shqetësim të parë mosnjohimin sipas rregullave si dhe duke kërkuar kompesim për shpronësimin sa më parë, me qëllim për të rikuperuar dëmin e shkaktuar. Por në fakt prishjet e objekteve dhe ndërtesave nga ana e IKMT-së janë bërë të menjëhershme dhe arbitrare, duke cënuar dhe dinjitetin njerëzor.

Veprimet e prishjes së objekteve prej punonjësve të IKMT-së janë konstatuar në vënd nga Ndhimëskomisionerët e Avokatit të Popullit, për të cilat janë mbajtur dhe proces verbalët përkatëse të datave 15 dhe 16 Prill 2015, të shoqëruara dhe me foto.

Nga analiza e veprimeve të kryera konstatohet se:

Së pari: Procedimi administrativ i kryer nga IKMT, mbi bazën e kërkesës së Autoritetit Rrugor Shqiptar me shkresën nr.2772, datë 31.03.2015, dhe Bashkisë Lushnje me shkresën nr.2842, datë 08.04.2015, nuk rezultoi i pasqyruar në ndonjë akt prej këtij organi

Punonjësit e IKMT-së gjatë aksionit të prishjes së objekteve në segmentin rrugor Rrogzohinë –Fier , realizuar në muajin Tetor 2014, dhe Prill 2015, nuk kanë respektuar procedurat e nevojshme, që lidhen me njoftimet apo vënien në dispozicion të shtetasve të dëmtuar të akteve ose vendimeve për prishjen. Kështu, ka ndodhur që subjekti është njoftuar për prishjen në mënyrë verbale nga punonjësit e INUV, tre deri në pesë ditë para, dhe në raste të tjera prishja është bërë menjëherë brenda ditës.

Për rastet e ndërtimeve pa lejë, por që janë në proces legalizimi, punonjësit e IKMT-së nuk kanë respektuar kërkesat e dispozitave ligjore të parashikuara në nenet 4, 8 dhe 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai vendor”. Pra, punonjësit e IKMT-së nuk kanë mbajtur proces verbal për konstatimin e faktit në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, e më pas vendimin për prishjen e objektit brenda 10 ditëve duke njoftuar dhe subjektin e kontrolluar.

Së dyti: Në mospasqyrimin sipas një proces verbali për konstatimin e shpenzimeve të prishjes, kërkesë kjo e nenit 20/1 të VKM nr.846 datë 27.10.2010, “Për një shtesë në vendimin nr.862, datë 05.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”.

Subjektet të cilëve u janë prishur objektet, kanë qënë të detyruar që materialet e mbetura nga shëmbja e tyre, t'i largojnë me shpenzimet e tyre, në një kohë që sipas pikës 5 të VKM-së të mësipëme duhet të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Sa sipër konstatohet se, procedurat administrative të zhvilluara nga IKMT-ja mbi bazën e kërkesës iniciuese së institucioneve apo organeve të tjera shtetërore, nuk rezultojnë të pasqyruara në ndonjë akt prej këtij organi.

Pasojat e ardhura nga mosveprimet apo veprimet e paligjshme të punonjësve të IKMT-së, janë si më poshtë:

1. Pasoja ekonomike-financiare kryesisht për rastet kur qytetarët kanë patur në objektet e ndërtuara me lejë ndërtimi, biznese. Kjo për faktin se jo vetëm që është dëmtuar, por dhe është ndërprerë aktiviteti i vënë me punën e kryer prej tyre ndër vite, apo kontributin e fëmijve të cilët punojnë në emigracion, kryesisht në Itali.
2. Pasoja në dëmin ekonomik, kryesisht në pajisje e materiale të biznesit, të shkaktuara nga kryerja e veprimeve të menjëhershme, apo pamundësisë së heqjes së tyre brënda një afatit shumë të shkurtër kohor.
3. Pasoja në vlera monetare të pajisjeve dhe orendive shtëpiake për rastet e ndërtimeve pa lejë si, në rastin e shtetasit Vath Kokja etj. Aktualisht personat që u janë prishur ndërtesat kanë shkuar në shtëpi me qera ose tek të afërm të tyre, duke rënduar edhe më shumë gjëndjen e tyre familjare.
4. Pasoja psikologjike dhe krijimi i stresit i bërë evident në momentin e prishjes së objektit e pas saj, më e theksuar kjo tek fëmijët e mitur, siç është rasti i pasqyruar në foto në familjen e shtetasit Kujtim Kaja në Grabian të Lushnjes.
5. Shkelja e parimit të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, pasi qytetarëve nuk ju është vënë në dispozicion një akt administrativ që do të shprehej mbi objektet e tyre informale, duke i mohuar të drejtën e njoftimit dhe ushtrimit të një mjeti efektiv të ankimit në gjykatë, parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ.

Duhet theksuar se e drejta për t'ju drejtuar gjykatës është një e drejtë kushtetuese, e cila ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cënimi vjen nga ndonjë akt i administratës.

Pavarësisht, kompesimit në vlera të përcaktuara sipas listës, për të cilat qytetarët kanë patur pretendimet e tyre duke i kundërshtuar ato në gjykatë, përsëri subjektet e prekura nga prishja e ndërtimeve kanë pësuar një dëm të pariparueshëm. Nga ana tjetër, punonjësit e IKMT-së duke vepruar në këtë mënyrë, pa asnjë kufizim në prishjen e ndërtimeve me lejë, dhe pa respektuar procedurat e nevojshme krijojnë gjëndje pasigurie dhe ankthi tek qytetarët. Dëmi financiar është i pariparueshëm edhe për shtetin, pasi subjektet e dëmtuara janë dëmshpërblyer për prishjen e objektit të ndërtuar me lejë.

Nëpërmjet prishjes së objekteve të ndryshme të ndërtuara me lejë, cënohet e drejta e pronës e cila është garantuar nga neni 41 i Kushtetutës së Shqipërisë, duke prekur thelbin e së drejtës së pronës së shtetasve pa një proces të rregullt ligjor, e cila bie ndesh me garantitë e nenit 42 dhe 17 të Kushtetutës.

Parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese e ligjore.

Avokati i Popullit më datën 07.01.2015, me shkresën nr.K3E48-2, i ka rekomanduar drejtuesit të IKMT-së, znj.Dallëndyshe Bici "*Marrjen e masave administrative për respektimin e procedurave ligjore, vënien në dispozicion të akteve që lidhen me procesin e prishjes së objekteve të banorëve në zonën e Hudenishtit Pogradec dhe pezullimin e çdo veprimi të mëtejshëm*". Në përgjigjen e kthyer nga Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, datë 13.01.2015, me shkresën nr.106/1 ndërmjet të tjerave shprehet se: "*...Prishja e objekteve është duke u kryer në përputhje të plotë me gjurmën e projektit dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Subjektet janë*

lajmëruar me kohë në lidhje me shpronësimin dhe prishjen e objekteve të tyre, me qëllim lirim të hapësirës në kuadër të zbatimit të projektit... ”

Pra, nga ai Institucion nuk ka një qëndrim korrekt, dhe asnjë përpjekje për marrjen e masave në zbatimin e detyrave të lëna nga rekomandimi i mësipërm. Për rrjedhojë nga punonjësit e IKMT-së kryesuar nga inspektor Keldi Keli, kanë vazhduar shkeljet dhe veprimet e paligjshme, duke mos zbatuar procedurat e nevojshme për prishjet e objekteve në segmentin rrugor Rrogozhinë –Fier dhe konkretisht në Çermë, Grabian dhe Dushk të Lushnjës.

Nga analiza në tërësi e rastit, rezulton se punonjësit e IKMT-së në kryerjen e funksioneve publike në sajë të detyrës shtetërore, me mosveprimet dhe veprimet e tyre të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës kanë dëmton interesat e ligjshme të shtetasve. Ka një lidhje shkaksore të drejtpërdrejtë midis veprimit dhe mosveprimit të kundërligjshëm, mospërbushje të rregullt të detyrës dhe dëmtimit të interesave të ligjshëm të shtetit dhe shtetasve. Në këto rrethana inspektori i IKMT-së Keldi Keli në bashkëpunim me persona të tjerë të atij institucioni, kanë konsumuar veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: “Avokati i Popullit, pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”,

REKOMANDOJMË

“Fillimin e hetimit në ngarkim të shtetasit Keldi Keli etj, me detyrë inspektor pranë I.K.M.T Tiranë, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal”.

Mbi qëndrimin që do të mbani ndaj rekomandimit, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, lutemi të na vini në dijeni brenda afatit 30 ditor.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. VKM nr. 229 datë 11.03.2015, me listën e personave të shpronësuar.
2. Kthim përgjigje nga IKMT, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, datë 22.04.2015, me dy dokumente.
3. Proces verbale të datës 15 dhe 16 Prill 2015
3. Ankesat e shtetasve Kujtim Kaja, Rustem Kokja, Rrahman Balliu, Ramadan Kokja, Hasan Kokja, Shkëlqim Kokja, Rustem Kokja, Vath Kokja, Avni Lila, Neim Lila, Luftim Dervishi, Ymer Kokja dhe Nazmi Muça.
4. Pyetësorë të datës 13.05.2015, për shtetasit Rustem Kokja, Avni Lila, Neim Lila, Bujar Kokja, Luftim Dervishi, Suzana Kokja dhe Nazmi Muça (shtatë dokumente)
5. Dokumente pronësie dhe lejë ndërtimi të shtetasit Kujtim Kaja.(-5-pesë dokumente).
6. Pamje, fotografi të objektit të shtetasit Kujtim Kaja para prishjes dhe objekte të shëmbura si, të shtetasit Rustem Kokja etj (-5- pesë foto).

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë dhe me porosi

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI